



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 22 nëntor 2019, në mbledhjen e XXV (njëzetepesë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës (Lista e nënshkrimeve), përveç znj.Endritë Murati dhe z.Adnan Zymeri, të cilët munguan.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, Drejtorët e Drejtorive (DPKGJ, DPZHE, DBF, DSHMS, DKA, DA, DBPZHR dhe DSHPMSH), përfaqësuesja e OSBE-së znj.Shkendiza Kllokoqi - Doroci, përfaqësues të mjeteve të informimit, një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, dhe duke i njoftuar rreth pikave të rendit të propozuar të ditës dhe rekomandimeve nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 20.11.2019, shtoi, tani për tani janë dy këshilltar/e që nuk janë prezent në sallë, andaj vazhdojmë me punime, urdhëroni a dëshiron ndonjëri të merr fjalën.

z.Rafet Lllashtica, theksoi, para se të futemi me pikat e rendit të ditës të cilat i kemi rekomanduar për shqyrtim në mbledhjen e KPF-së, kam një propozim, jo që të përfshihet në kuadër të rendit të ditës, mirëpo që Kryetari i Komunës ta ketë parasysh dhe se vendimi të merret në momentin më të volitshëm dhe në harmoni me legjislacionin.

Duke pasuar parasysh që shumica e regjioneve, sa jam i njoftuar, kanë formuar Drejtorinë e Mbrojtjes, e që vetëm regjioni i Prishtinës funksionon përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Ekzekutivi i Komunës, përkatësisht Kryetari i Komunës z.Agim Veliu, të formoj Drejtorinë e Mbrojtjes, Shpëtimit dhe Emergjencave, pasi që është formuar edhe Ushtria e Kosovës. Sipas legjislacionit kjo Drejtori do të funksiononte në nivelin e duhur të mbrojtjes dhe sigurisë së emergjencave si dhe do të rritej punësimi me një Drejtori shtesë dhe staf të mbrojtjes dhe shpëtimit. Pra ky të mbetet një propozim që në momentin e parë Kryetari i Komunës të merr vendimin në harmoni me legjislacionin në fuqi të mbrojtjes në nivel vendi.

Edhe njëherë, ky propozim vë nga subjekti Partia Demokratike e Kosovës-Dega Podujevë, dhe është në harmoni me ligjin, dhe mendojmë se për momentin dhe gjendjen që jemi do të ishte një ndër Drejtoritë e cila do të kryente detyrën e vet në lidhje me mbrojtjen dhe sigurinë emergjencat dhe shpëtimin duke pasur parasysh që ky dikaster funksionon për momentin përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit e cila nuk mund ta kryej funksionin adekuat për mbrojtje shpëtim dhe emergjenca ku me këtë dikaster sa i përket legjislacionit do të kryenin edhe obligimet e veta ndaj të gjitha fushave të sigurisë ku pjesë e tyre do të ishin edhe zjarrfikësit që për momentin funksionojnë në Komunën e Podujevës, por sa jam i njoftuar janë e vetmja degë ajo e zjarrfikësve që janë me koeficientin më të ulët të pagave në nivel Komune.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ishte një propozim konkret që i bëhet Kryetarit të Komunës, do të thotë kishte të bëjë me ngritjen e sektorit për emergjenca i cili funksionon në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, konkretisht të themelohet një Drejtori për mbrojtje dhe emergjenca. Vlen të ceket se në disa prej mandateve të kaluara ka qenë e ngritur kjo Drejtori, mirëpo mbetet të shikohet arsyeshmëria dhe çfarë të ndërmerret më tutje.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës së bashku me konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 20 nëntor 2019.

1. Propozimi i Vendimit për vënie në diskutim publik Draft Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020 – 2022

z.Mirsad Kamerolli, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, Strategjia në fjalë paraqet dokumentin më të lartë në nivel lokal e cila orienton Komunën drejt zhvillimit të qëndrueshëm, dokument sipas të cilit Komuna ofron vizion dhe mision, përcakton qëllim strategjik, objektiva të matshme dhe mjete për të orientuar Podujevën drejtë një Komune të zhvilluar, qytet i cili sikurse edhe qytetet tjera në nivel të Kosovës pas luftës është ballafaquar me infrastrukturë dhe industri të rrënuar, institucione shkollore dhe administratë të trashëguar nga periudha e paraluftës, mungesë të shërbimeve adekuate shëndetësore si dhe shumë probleme të tjera të cilat kanë shumë fishuar problemet sociale të qytetarëve gjatë 20 viteve të fundit, pothuajse gjysma e investimeve kapitale kanë shkuar në ndërtim të infrastrukturës rrugore, kanalizimit, ndërtimit dhe rindërtimit të shkollave dhe objekteve tjera përcjellëse, dhe duke kompletuar pothuajse në tërësi këtë infrastrukturë për një qytet funksional.

Ndërsa ndër sfidat kryesore mbetet zhvillimi ulët i sektorëve të prodhimit, modernizimi i fermave dhe kultivimi i produkteve bujqësore me vlerë të shtuar, sigurimi i cilësisë në arsim, mjedisi shkollorë, ofrimi i shërbimeve sociale cilësore, rritja e numrit të shërbimeve shëndetësore nga shërbimi i kujdesit primar shëndetësorë si dhe zhvillimi i kulturës dhe sportit.

Kjo strategji ofron pasqyrim tejet realistik të gjendjes së sektorëve rritës dhe mbështetës të ekonomisë lokale, thekson nevojën, paraqet sfidën dhe mundësitë për përmirësimin dhe përcakton rrugën për një Komunë të suksesshme për të gjithë.

Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal ka kërkuar një qasje gjithëpërfshirëse që përmban akter nga institucione dhe fushat multidisciplinare për shkak të mundësisë ekonomike, gjeografike dhe sociale të Podujevës, dhe për këtë arsye ne kemi zbatuar metodologjinë e punës e

cila siguron pjesëmarrje të plotë të akterëve nga fushat kryesore që ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm. Për hartimin e këtij dokumenti dhe për një analizë të mirëfilltë, janë mbledhur informacione primare dhe sekondare, gjithashtu janë zhvilluar informata të tjera nga institucione të nivelit qendror si; Agjensioni Zhvillimor i Bujqësisë, Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, trusti pensional dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

Për më shumë janë organizuar takime dhe intervista dhe fokus Grupe me përfaqësues dhe hisedarët kryesor të kësaj strategjie, duke filluar nga bizneset prodhuese, fermerët, shoqatat bujqësore, nxënësit, arsimtarët dhe Ekzekutivi i Komunës.

Ky dokument bazohet në 3 qëllime kyçe strategjike që i mundëson Komunës të ketë një përparim në zhvillimin e Komunës tonë në tri vitet e ardhshme, dhe atë;

1-Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik nëpërmes përmirësimit të vazhdueshëm të sektorit privat dhe nxitjen e zhvillimit të hovshëm dhe të qëndrueshëm ekonomik me qëllim të gjenerimit të punësimit me vlerë, arritja e këtij qëllimi strategjik mundësohet nëpërmes rritjes së investimeve publike infrastrukturore që mundëson ambientin e të bërit biznes me theks të veçantë ndërtimin dhe funksionalizimin e zonës ekonomike, nxitjen e investimeve përmes partneritetit publiko-privat, stimulimin dhe zhvillimin përmes investimeve të huaja direkte, zvogëlimin e deficitit tregtarë përmes rritjes së konkurrueshmërisë dhe eksportit të prodhimeve vendore dhe rritjen e prodhimit lokal, nxitjen e ndërmarrësisë tek të rinjtë përmes hapjes së bizneseve Strat Up, të qëndrueshme.

2-Qëllim tjetër strategjikë është zhvillimi i qëndrueshëm social nëpërmjet fuqizimit të qytetarëve për të realizuar potencialin e tyre të plotë përmes sigurimit të mundësive të barabarta në arsim, shëndetësi dhe jetë sociale cilësore. Arritja e këtij qëllimi strategjik mundësohet përmes përmirësimit të kushteve të jetesës, ndërtimit të një sistemi gjithëpërfshirës dhe llogaridhënës të arsimit me menaxhim cilësor dhe mësimdhënës të kualifikuar dhe të përgatitur në mjedis krijues dhe kushte që siguron edukim dhe arsimim për nxënësit, krijimit të infrastrukturës së fortë me shërbime shëndetësore cilësore që u mundëson qytetarëve të gëzojnë shëndet të mirë, krijimin e një jete më të dinjitetshme për të gjithë qytetarët e në veçanti për personat me nevoja të veçanta dhe ata të moshuar, si dhe nëpërmjet investimeve për rini të shëndosh për kulturë, rini dhe sport të zhvilluar.

Këto 2 qëllime strategjike për Komunën tonë nuk mund t'i arrijmë pa një menaxhim efikas dhe eficient të Komunës përmes përmirësimit të vazhdueshëm të menaxhimit njerëzorë dhe financiar bazuar në praktikën e mira ndërkombëtare të qeverisjes lokale, prandaj qëllimi i 3-të strategjik mbetet menaxhimi i qëndrueshëm, arritje e këtij qëllimi mundësohet nëpërmjet optimizimit dhe zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese për përmirësim të vazhdueshëm të performancës të Komunës, bashkërendimit të politikave, qëllimeve operative dhe fondeve të Komunës me prioritet qytetarët, fermerët, sektorin privat, rrinin dhe Shoqërinë civile, ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme të përgjithshme me cilësi të lartë për banorët, sigurimin e qëndrueshëm financiar afatgjatë të Komunës përmes menaxhimit të shënosh të financave dhe hyrjen e vazhdueshme të të hyrave vetanake, komunikim të hapur dhe efikas mes Komunës dhe palëve të interesit, n'këtë rast qytetarët, fermerët, sektori privat, rinia dhe Shoqëria civile.

Ky dokument ofron zgjidhje praktike për shumë probleme aktuale që përmirëson pozicionin konkurrues të Podujevës n'raport me Komunat tjera, dhe konform këtij pozicioni konkurrues dhe kufizimeve buxhetore janë përcaktuar masa, projekte dhe hapa kyç për periudhën 2020-2022, prandaj kërkoj nga Ju që ky dokument të votohet dhe të vëhet në diskutim publik, njëkohësisht pres vërejtjet, komentet dhe sugjerimet e juaja.

Për informacion, pas inkorporimit të vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve pas kalimit të fazës së diskutimit publik, ky dokument do të jetë i shtypur në tri gjuhë, Shqip, Anglisht, dhe Gjermanisht.

Për fund, unë bëra një hyrje të shkurtër rreth dokumentit të draft Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal, ndërsa për të gjitha pyetjet dhe sqarime që dëshironi, mund t'iu drejtoheni edhe drejtorëve tjerë varësisht fushave përkatëse.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e LDK-së, e përkrah këtë propozim vendim për vënie në diskutim publik të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal për periudhën 2020-2022. Sigurisht që sugjerimet tona do të japim edhe në diskutimin publik që do të mbahet por edhe me rastin e shqyrtimit final që do të sjellët sërish për miratim në këtë Kuvend.

Për nga përvoja që kam, është e rëndësishme të potencohet që Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, është e vetmja e emërtuar në nivel Kosove me këtë emërtim, e që për fat të keq në shumicën e herave ka qenë jo përkrahur mirë me buxhet dhe mos përkrahja e mirë me buxhet e një Drejtorie kam frikë që mund të prodhoj dokumente shumë të rëndësishme ndoshta edhe sektoriale, por që mund të përfundojnë sikur fontan dëshirash, kështu që për të qenë dokumenti i mirë duhet të ketë besueshmëri të mirë edhe me Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe me buxhet përcjellës, por edhe Drejtorisë në fjalë duhet t'i rritet buxheti në mënyrë që të realizoj gjitha ato projekte që janë të pasqyruara në strategji.

z.Vendenis Lahu, theksoi, Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal është pa dyshim dokumenti më i rëndësishëm i nivelit lokal që sot na është sjellë si draft para asamblësë komunale për votim për vënie në diskutim publik dhe pastaj pas diskutimit për votim për miratimin e tij.

Sfidat dhe problemet me të cilat përballet Komuna e Podujevës janë të mëdha dhe në të gjitha sferat e jetës, si papunësia, arsimit, shëndetësia, degradimi urban dhe ambienti etj, probleme të cilat duhet të analizohen saktë përmes një skanimit të gjendjes, analizimit të të gjithë sektorëve dhe këto në funksion të një planifikimi të politikave dhe masave konkrete për arritjen e objektivave. Në parim ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e mbështesim hartimin e Strategjisë në fjalë dhe e kemi kërkuar në vazhdimësi hartimin e saj, por për hartimin e kësaj strategjie ne mendojmë se duhet angazhim i madh i resurseve njerëzore duke filluar nga ekspertët që punojnë në administratën komunale, asamblastët e Kuvendit komunal, ekspertët e pavarur të ekonomisë, bizneset, ekspertët e arsimit, shëndetësisë, urbanizmit e kështu me radhë. Sa kemi parë në këtë draft strategji shihet se ka pasur mungesë të bashkëpunimit, në fillim të dokumentit ku është paraqitur ekipa punuese ceket se kanë marrë pjesë drejtorët komunal si dhe një ekip e vogël e kompanisë MDA e cila edhe ka fituar tenderin për hartimin e kësaj strategjie dhe si rezultat kemi një dokument i cili bënë një përshkrim të gjendjes duke paraqitur më mirë se sa që është dhe duke treguar përparimet e punës së qeverisjes 20 vjeçare në Komunën tonë, dhe në fund ajo që është më rëndësishmja, aty ku janë të paraqitura qëllimet strategjike, objektivat dhe masat janë të paraqitura vetëm në terme të përgjithshme që nënkupton qartë se kjo draft strategji është e hartuar pa një analizim dhe pa një studim të hollësishëm dhe profesional të objektivave dhe masave që duhet ndërmarrë për të arritur objektivat e paraqitura. Ne si LVV jemi të gatshëm që të japim kontributin tonë gjatë diskutimeve publike, por nëse do të ketë vetëm një diskutim publik sa për procedura ne nuk do ta mbështesim.

znj.Floretë Zejnullahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e përkrahë propozim vendimin për vënie në diskutim publik draft Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2022. Pasi kjo strategji do të dal në diskutim publik, vërejtjet dhe komentet ne do ti japim gjatë ditëve në vazhdim dhe në debatin publik, si dhe kur të sjellët për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

znj.Donjeta Jakupi, theksoi, kam kërkesë për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, meqë edhe arsimit është pjesë e kësaj strategjie, i nderuar drejtor a keni shqyrtuar mundësinë e sigurimit të transportit përveç fëmijëve/nxënësve që jetojnë në një distancë mbi 4 km prej shkollës në shtëpi dhe anasjelltas. Edhe nëse nuk është rruga mbi 4 km, çka për ata fëmijë/nxënës të cilët vijnë në mësimin dhe që rrugëtimi i tyre bëhet në rrugë të ndryshme në të cilat ka një shkallë të rrezikshmërisë së lartë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë propozim vendim së bashku me dokumentin përkatës si dhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua propozimi i vendimit për vënie në diskutim publik Draft Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020 – 2022, sipas materialit të dërguar dhe Konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së, e mbajtur më 20 nëntor 2019.

2. Propozimi i Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020

- **Raporti i Ministrisë së Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, mbi vlerësimin e përgjithshëm për objektet rezidenciale në Komunën e Podujevës, (për njoftim)**

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, duke u bazuar në Ligjin nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, si dhe instruksionet e Departamentit të Tatimit në Pronë të Ministrisë së Financave, po paraqesë para juve propozim rregulloren për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020. Po ashtu marrë për bazë nenin 9 të Ligjit të cekur, kemi propozuar normën minimale tatimore prej 0.15% për pronat rezidenciale, bujqësore, pyjore dhe gjitha pronat tjera përveç objekteve komerciale dhe industriale për të cilat është propozuar një normë prej 0.20%, duke theksuar se sipas Ligjit, normat tatimore fillojnë nga 0.15% minimum dhe 1% maksimum për m².

Të nderuar këshilltarë të Kuvendit duke u bazuar në nenin 17 të Ligjit për tatimin në pronë, autoritet për zbatimin e proceduarave për vlerësim, dhe nenin 18 vlerësimi i pronave të paluajtshme është Ministria e Financave, andaj bazuar në këto kompetenca vlerësimi për pronat bujqësore dhe ato pyjore është bërë gjatë vitit 2018 me një afat të vlefshmërisë 3 deri 5 vite, kurse vlerësimi i pronave rezidenciale është bërë në vitin 2019 me një afat të vlefshmërisë deri në 5 vite.

Ministria e Financave ka mbet pa e përmbushur obligimin e saj ligjor mbi vlerësimin për pronat komerciale dhe ato industriale, vlerësim i cili është bërë për vitin 2020 dhe për të cilin do të kemi raporte sikurse për pronat rezidenciale dhe ato bujqësore, andaj bazuar në këtë ka mbet obligim i Kuvendit të Komunës që të miratoj norma tatimore për të gjitha kategoritë si dhe vlerësimin e normave tatimore për pronat komerciale dhe industriale sipas rregullores për vitin 2020.

Afati për miratimin e normave tatimore sipas Ligjit është data 30 nëntor 2019.

Pra kjo ishte në pika të shkurtra, për çka unë deshta të jap sqarime lidhur me këtë propozim rregullore.

z.Bajram Ajeti, theksoi, lidhur me këtë propozim rregullore, mendojmë se realizmi i tatimit në pronë në Komunën e Podujevës ka disa problematika që ne si LVV i konsiderojmë shqetësuese për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik shoqërorë dhe që na shqetësojnë për parimet dhe idetë e majta tek të cilat ne besojmë, andaj për këtë arsye edhe jemi të shqetësuar.

Realizimi i tatimit në pronë, nuk po realizon dy parimet themelore, atë të barazisë dhe parimin e drejtësisë. Edhe në bazë të të gjeturave të Auditorit të Përgjithshëm, janë 18000 prona që nuk tatimohen, dhe kjo është e padrejtë dhe që tregon se qytetarët nuk trajtohen të barabartë.

Ne si LVV konsiderojmë të padrejtë ndarjen e zonave ku në zonën e parë janë përfshirë, shembull, edhe rr.”Zahir Pajaziti” edhe rr.”Ilir Konushëfci”, madje 2 lokale me sipërfaqe të njëjta tatimohen njëjtë kur dihet që qiraja e lokaleve midis këtyre dy rrugëve ka dallim deri në 10 fish.

Kategoritë e vlerës nuk janë aspak të sakta dhe nuk dihet se ku është bazuar, duke shqyrtuar dokumentet e Ministrisë së Financave, edhe atë vërehen se nuk është bërë vlerësimi real, madje

akoma nuk është bërë por që është në proces, posaçërisht kur është në pyetje përcaktimi i kriterit të shitblerjes e që nuk ka asnjë të dhënë për asnjë zonë të Komunës tonë.

Ne LVV, propozojmë që kjo rregullore të mos miratohet në këtë seancë, por të rishikohen në tërësi, zonat tatimore, dhe të bëhet riorganizimi i zonave, kategoritë e vlerës të rishikohen dhe normat tatimore tek bizneset industriale të rishikohen, dhe për këto biznese prodhuese të shkohet tek minimumi i vlerës që përcaktohet me Ligj, përkatësisht në 0.15% e jo ashtu siç propozuar në 0.20%. Pra këto ishin disa propozime tonat si LVV, dhe po ashtu kërkoj të mos ngutemi ngase vetëm ta marrim shembull, zona e parë apo qendër, jeni në dijeni se çfarë maltretimesh kanë vetëm me këto punime që po bëhen rreth rrugëve, kanalizimeve, pastaj do të ndodh edhe gjatë punimeve për sheshin, prandaj mendoj se duhet të merren parasysh edhe këto rrethana rënduese që do të kenë bizneset në zonën qendër sepse është vlerësuar si zonë dhe është tatimuar me këto vlera duke konsideruar se atyre vërtetë iu ofrohet një infrastrukturë me kushte shumë të volitshme për të zhvilluar biznesin e tyre.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në bazë të njoftimit që drejtori i DBF e bëri në mbledhjen e KPF-së, dhe asaj që sot e potencoj, ne kemi për të miratuar normat tatimore për vitin 2020 deri më 30 të këtij muaji. Duke parë normat tatimore kemi vërejtur që ato janë minimale dhe nuk kemi vërejtur ndonjë që mund të jetë e lartë apo ekstreme, apo ndonjë që mund ta zbresim. Pra kemi vërejtur që është menduar që qytetari të mos dëmtohet as nga ne as nga Ekzekutivi i Komunës. Mirë është që ka lehtësime në vitin 2020 ngase sipas asaj që edhe drejtori i DBF na njoftoj se tatimi do të bëhet vetëm për pyje, oborre dhe shtëpi banimi, kurse toka bujqësore nuk do të të futet tatimi.

Në këtë parim, sa i përket normës tatimore ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e mbështesim këtë normë sepse nuk mund të shkohet më poshtë, sipas Ligjit. Sa i përket vlerësimit të pronës ndihemi të hendikepuar për arsye se vlerësimin e normës për prona e bënë Ministria e Financave, dhe në Komunën tonë nuk kemi vlerësim të normës që do të sanksiononte qoftë si Legjislativ qoftë si Ekzekutiv i Komunës që të formohej ndonjë trupë për vlerësim, por që nuk do të futesha në këtë temë, mirëpo që pajtohem kështu siç është sepse norma nuk mund të shkoj më ultë se që është përcaktuar në minimum. Sa i përket propozimit të këshilltarit parafolës z.Bajram Ajeti, për ndarjen e zonave, është ndarje që e ka bërë Ekzekutivi i Komunës, por edhe përkundër kësaj, nuk e kuptova saktë se ai propozim ishte para se të miratohet kjo propozim rregullore apo jo, nëse ke propozuar të ndërrohen zonat, ne duhet të votojmë para se të miratojmë normën tatimore.

E them këtë sepse në bazë të diskutimeve, ne hymë në dy fusha të ndryshme, njëra rreth propozimit të këshilltarit parafolës dhe tjetra rreth ndryshimit të normave, andaj për norma tatimore ne konsiderojmë se janë në rregull, kurse sa i përket ndarjes së zonave konsiderojmë se është të mbetet pikë diskutimi para miratimit të kësaj propozim rregulloreje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, sqarim, dokumenti do të del në votim ashtu siç është dërguar si propozim i Kryetarit të Komunës. Nëse nuk gaboj edhe pyjet parashihen të tatimohen.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, theksoi, në këtë dokument zonat tatimore kanë të bëjnë vetëm me pronat komerciale dhe ato industriale, ndërsa zonat të cilat janë të përcaktuara për pronat rezidenciale në Komunën e Podujevës, Ministria e Financave, ashtu siç shihet edhe në hartën e raportit, ka përcaktuar 18 zona dhe në bazë të tyre më shumë kanë shkuar në bazë të përcaktimit të zonave gjeografike duke u bazuar në kriteret përkatëse sipas raportit, por që me siguri atyre iu kanë munguar shumë dokumente, shembull kontrata e shitblerjeve, pastaj kanë mund të jenë kontrata fiktive, kanë mund të jenë kontrata jo reale, por megjithatë në raport shkruan se cilat kritere janë marrë për bazë për përcaktimin e secilës zonë, ndërsa përcaktimi i zonave bujqësore dhe pyjore në raport janë 11 zona në kuadër të Komunës së Podujevës. Sigurisht që me përcaktimin e zonave në vitin e ardhshëm për pjesën që ka mbetur për prona komerciale dhe rezidenciale ndoshta do të ketë shumë më shumë

zona se sa që janë të përcaktuara tani, e që në këtë propozim rregullore janë të përcaktuara 4 zona ku 3 zona janë që përfshijnë qytetin ndërsa zona 4 përfshinë të gjitha fshatrat e Komunës së Podujevës, çështje për të cilën mendoj se nuk ka shkelje, përkundrazi ndoshta në zonën 3 do të ishte shumë më mirë të përfshiheshin edhe disa fshatra përreth qytetit të cilat siç jemi në dijeni qëndrojnë ekonomikisht më mirë se sa fshatrat të cilat janë në largësi 20-30 km prej qytetit të Podujevës, por megjithatë edhe në këtë propozim rregullore ashtu siç ka qenë edhe në rregulloret e mëparshme nuk kemi dashtë të bëjmë riorganizime për shkak se kjo sigurisht do të përcaktohet në vitin e ardhshëm nga Ministria e Financave sepse ekskluzivisht i takon asaj, për çka edhe në këtë vite ka pasë obligim vetë Ministria e Financave të bëjë një riorganizim të tillë edhe për këtë pjesën që kemi propozuar për miratim por që nuk kanë arrit ta bëjnë dhe për këtë ka mbet obligim i Komunës edhe për këtë vit, por për vitet tjera sigurisht do të punohet sipas ligjit sipas të cilit Kuvendit të Komunës definitivisht i mbetet të përcaktoj vetëm normat tatimore e që nuk do të bëhet me rregullore por do të rregullohet vetëm me një propozim vendim të Kryetarit të Komunës ngase ka të bëjë vetëm me një segment ku do të vendoset vetëm në mes të minimumit dhe maksimumit të përcaktimit të normës, e që deri tani ne kemi shkuar çdo herë në minimumin e minimumit.

Sa për njoftim, unë hulumtova dhe pash një rregullore të komunës së Lipjanit ku pronat komerciale dhe rezidenciale janë me normë tatimore prej 0.30%, do të thotë se mbesim në mesin e Komunave me një ekonomi të varfër andaj edhe kemi menduar që këto norma tatimore të jenë sa më të ulëta në mënyrë që ato obligime që dalin për qytetarët të jenë të pagueshme, e jo vetëm të përcaktojmë norma dhe të mos paguhen.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj parafolësit për kontributin e tyre, me theks drejtorin e DBF për sqarimet e detajuara, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e hedh në votim këtë propozim rregullore sipas materialit përkatës dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 22 vota për, 9 vota kundër dhe 2 vota të përmbajtura, u miratua propozimi i Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020, me rekomandim që pjesë e Rregullores të jetë edhe Raporti i Ministrisë së Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, mbi vlerësimin e përgjithshëm për objektet rezidenciale në Komunën e Podujevës.

3. Ngritja e Grupit punues për hartimin dhe përgatitjen e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2020

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ne edhe në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar rreth ngritjes së Komisioni në fjalë dhe jemi pajtue që t'i rekomandojmë Kuvendit që të vendos për ngritjen e këtij grupi dhe formulës së përfaqësimit në këtë grup.

z.Avni Fetahu, theksoi, në fakt ne kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së, kemi pas një disponim që në hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2020 të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës për arsye të gjithë kanë peshën e vetë, mirëpo duke marrë parasysh që mos t'iu marrim kohë të gjithëve sepse ai plan sërish do të sjellët këtu në Kuvend për shqyrtim dhe miratim dhe do të ketë mundësi secili të japë sugjerimet e veta për ndonjë pikë të planit gjatë vitit 2020, ishte një dakordancë që në kuadër të grupit punues të jenë nga 2 këshilltarë të Grupeve përfaqësuese të Kuvendit, ndërkohë sërish ka një interesim që të jenë vetëm nga një anëtar, andaj

nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së propozohet znj.Fatlume Jaha, mirëpo ashtu siç e sheh të arsyeshme Kuvendit ashtu të vendos.

z.Bajram Ajeti, theksoi, planifikimi është një kategori, nëse mund ta quaj kështu, që njeriu vërtetë është një qenie njerëzore dhe ka të menduarit e vet për të zhvilluar aktivitetin e vet dhe jetën e vet duke planifikuar, mirëpo të planifikosh duhet edhe ta respektosh sepse duhet edhe ta zbatosh atë.

E them këtë ngase për nga përvoja e deritanishme kemi vërejtur që edhe plani i punës së Kuvendit për vitin 2018, edhe pse ka qenë gjysmak, por edhe ai i cili u plotësua me rastin e vizitës në Republikën e Shqipërisë për vitin 2019 për të cilin u dhanë shumë ide, sugjerime etj, por megjithatë prap nuk u zbatua ai plan, e që unë mendoj se kjo nuk është diçka serioze sepse kur përgatitet një plan, ai edhe duhet të zbatohet. Pajtohem me parafolësin z.Avni Fetahu dhe është e vërtetë se gjithë këshilltarët e Kuvendit kanë peshën e tyre, por të thuhet ashtu dhe në fund të bie në nga një anëtar nga Grupet, unë mendoj se do të ishte mirë që të shkohet me nga dy anëtarë të Grupeve, dhe me kusht që propozim plani të diskutohet sërish në këtë Kuvend si dhe pastaj pas miratimit i njëjti të zbatohet. kështu që për fund, ne mbetemi pran asaj që të shkohet me nga dy anëtarë prej Grupeve, dhe nga Grupi i këshilltarëve të LVV-së propozohen z.Fitim Muçolli dhe znj.Doruntina Hasani.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, parimisht si rregull është që planin e punës së Kuvendit e përgatitë Kryesuesi i Kuvendit së bashku me përfaqësuesit e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit në bazë të propozimeve të sjella nga Ekzekutivi i Komunës në seanca të rregullta të Kuvendit për miratim dhe ligjshmëri, varësisht nevojës. Besoj se të gjitha grupimet politike mund të ngrisin debat vetëm sa për të dalë në foltore dhe të flasim, por nuk jam në dijeni tani se Drejtoritë e Komunës a kanë sjellë propozimet e tyre ngase secili prej drejtorëve është në dijeni se në fund të secilit vit përgatitet plani i punës për vitin e ardhshëm, dhe ato kërkesa apo pika të Ekzekutivit, në bazë të planit afatmesëm dhe afatshkurtër që kanë për vitin e ardhshëm e parashohin rendin e ditës i cili pastaj mund të ndryshoj me ndonjë kërkesë qoftë të seancave të ngutshme apo të jashtëzakonshme. Nga parafolësit pati mendime të ndryshme sa i përket numrit të anëtarëve të këtij grupi punues, mirëpo konsideroj se planin e punës së Kuvendit e përgatit Kryesuesi i Kuvendit bashkërisht me përfaqësuesit politik të subjekteve të Kuvendit, andaj a është 1 anëtar apo janë 2, është shumë pak e rëndësishme, por e rëndësishme është që ai plan të përgatitet, të sjellët në Kuvend si dhe para miratimit Kryesuesi i Kuvendit t'iu dërgoj edhe njëherë drejtorëve kërkesë për sjelljen e materialeve ose pikave të planifikuara për përfshirje në plan, mirëpo me një qëndrim personal të tij që kur të hyjë rendi i punës së Kuvendit, të mos e pranoj rendin e ditës, gjë e cila jam shumë i sigurt se nuk bëhet në Komunën e Podujevës. Përndryshe ne mund të shkojmë si tërësi i gjithë Kuvendi, por plan të punës nuk mund të bëjmë, por secili shef i Grupit të këshilltarëve duhet të merr propozimet e anëtarëve të Grupit që i takon dhe të njëjtat t'i paraqet në grupin punues në mënyrë që të shqyrtohet dhe të përcaktohet apo jo pika përkatëse në plan të punës. Si do që të përgatitet ai plan pune, do të jetë i hartuar bashkërisht, por unë në një formë mendoj se kur është Kryesuesi i Kuvendit pjesë e atij grupi punues, shefat e Grupeve të këshilltarëve si dhe anëtarët e subjekteve tjera, duke mos dashur t'i injorojmë në aspektin shumicë/pakicë, do të ishte më e natyrshme të jenë edhe nga një prej përfaqësuesve të AAK-së, PD-së, OBKD, dhe të tjerë edhe pse nuk kanë grup, të japin idetë dhe mendimet e tyre në mënyrë që pastaj të mos kenë pakënaqësi askush. Pra të formohet ky Grup prej Kryesuesit, përfaqësuesve të Grupeve të subjekteve politike, anëtarët tjerë të subjekteve, të përgatitet plani i punës si propozim, të sjellët në seancën e radhës ku edhe mund të shqyrtojmë dhe diskutojmë sërish të gjithë këshilltarët para miratimit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, do të thotë kemi dy propozime rreth formimit të grupit punues, 1-me përfaqësim të të gjitha subjekteve me nga një anëtar, 2-me përfaqësim të Grupeve me nga dy anëtarë, andaj vendoseni si të dëshironi ju, mirëpo ta keni parasysh se menjëherë

pas ngritjes së tij, përkatësisht pas kësaj seance duhet të ulemi të hartojmë propozim planin për arsye se ne mendojmë ta mbajmë edhe një seancë diku rreth 5 ose 6 dhjetor dhe për këtë thirrja dhe materiali duhet të dërgohet më së largu deri të martën.

z.Avni Islami, theksoi, mendoj që dy propozimet e bëra janë të qëlluara mirëpo konsideroj që propozimi i dytë i këshilltarit nga radhët e PDK-së është më denjë për shkak se në grupin punues përkatës do të përfaqësohen të gjitha subjektet që janë pjesë e Kuvendit e që do të mund të japin vërejtjet, sugjerimet dhe komentet e tyre.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, do të thotë kemi dy propozime, njëri ishte që të përfaqësohen të gjitha subjektet politike në grupin punues plus Kryesuesi i Kuvendit, dhe tjetri ishte nga dy anëtarë prej Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit.

z.Bajram Ajeti, theksoi, plani në fjalë është plan i Kuvendit të Komunës, pra kontributin duhet ta japin vetë këshilltarët e Kuvendit, andaj përzierja e përfaqësuesve të Kuvendit dhe përfaqësuesve nga subjektet politike mendoj se nuk është e drejtë ngase se ky është dokument i Kuvendit, jo i partive politike. Partitë politike, përmes këshilltarëve të tyre mund të japin sugjerimet e tyre të cilët pastaj duhet t'i paraqesin këtu, ama jo të bëhet një përzierje e tillë. Unë e bëra një propozim dhe mbetëm pranë asaj që secili Grup i këshilltarëve të ketë nga dy përfaqësues dhe kontributi i këshilltarëve tjerë të subjekteve që nuk përfaqësohen me dy a më shumë këshilltarë mund të jetë direkt apo indirekt, kështu që unë e përkrahi propozimin që grupi punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të përbehet prej asamblistëve.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, sqarim parafolësit, i nderuar, asamblist jemi të gjithë këtu, qoftë ata që janë nga një prej subjekteve politike qoftë ata që janë më shumti se një.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, çdo parti politike i ka asamblistët e vet, shembull, asambleiste është znj.Mrika Thaqi nga radhët e AAK-së, do të thotë përfaqëson parti politike, andaj s'ka të bëjë këtu me parti ashtu siç e ceku këshilltari parafolës z.Bajram Ajeti. Pastaj parti është edhe Balli Kombëtar Demokratik dhe ka përfaqësuesin e vet që është z.Avni Islami. Prandaj kurrfarë kompetence tjetër nuk kemi ne në raport me një këshilltar që është i vetëm nga një subjekt politik, përveç Kryesuesit të Kuvendit i cili e ka një kompetencë më shumë se ne, votën e dyfishtë. Proceduralisht në asnjë institucion planin e punën nuk e hartojnë të gjithë, por ngritët një trupë punuese dhe hartohet një dokument i tillë. Në fakt ne po e zgjatim paska këtë temë, por ashtu siç e ceku Kryesuesi që menjëherë pasë kësaj mbledhje duhet të takohet grupi punues, mendoj se nuk jemi të përgatitur asnjëri, madje jo dy këshilltarë që po kërkon këshilltari në fjalë, por të gjithë të shkojnë se nuk do të mund t'i paraqesin 10 tema po që se edhe tri orë nëse të jepen kohë sepse nuk jemi të përgatitur tani dhe duhet ta pranojmë, andaj mos ta bëjmë kaq problematike këtë çështje sepse në fakt Kuvendi i Komunës është në funksion të Ekzekutivit të Komunës për t'i legjitimuar kërkesat e tyre.

Unë edhe më parë e ceka, nëse Kryesuesit të Kuvendit i kanë arritur materialet nga Ekzekutivi i Komunës për t'i përfshirë në seancat e Kuvendit në vitin e ardhshëm, plani i punës duhet të jetë në funksion të Ekzekutivit dhe në harmoni me ligjin dhe parashikimet Ekzekutive, ndërsa në qoftë se Kryesuesit të Kuvendit nuk i është sjellë asnjë material nga Ekzekutivi Komunës, grupi punues vetëm do të ulet dhe do të shkruaj diçka, përndryshe ashtu siç e ceku Kryesuesi, disa Drejtori kanë sjellë materialet dhe unë i mbështesë që ato të futen në plan të punës ashtu siç kanë paraparë ata.

Prandaj të mos insistohet që të dërgohen nga dy këshilltarë sepse nuk është e arsyeshme, përndryshe nëse dëshironi i nderuari Ajeti, ne Grupi i PDK-së ju lëshojmë edhe një dhe urdhëroni dërgoni tre nga ju, ne dërgojmë vetëm shefin e Grupit, kurse propozimet tona i dërgojmë përmes shefit dhe janë qëndrime të subjektit tonë. Pra i nderuar Kryesues, unë në emër të Grupit të PDK-së, propozoj z.Fatmir Rudarin për anëtar të grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin

2020, kurse për formulën ishte propozim i imi që të përfaqësohen të gjitha partitë politike të Kuvendit në atë grup punues.

z.Hasan Ajeti, theksoi, patëm dy propozime rreth ngritjes së grupit punues, nëse shkojmë me propozimin e parë, atëherë unë propozoj të shkojmë në bazë të fuqisë së votës sepse fundja ne kemi dalë në votime dhe karshi fuqisë së votës të kemi edhe përfaqësuesit tanë në këtë grup.

znj.Mrika Thaqi, theksoi, është për keqardhje të debatohet aq gjatë për ngritjen enjë grupi punues për hartimin e planit të punës. Mendim i imi është që të hidhen në votim të dy propozimet. Unë i jap mbështetje propozimit të z.Rafet Llapashticës sepse konsideroj se patjetër duhet të përfaqësohen të gjitha subjektet politike në grupin punues në fjalë, e jo të injorohen, prandaj edhe kërkoj që fillimisht të hedhen në votim dy propozimet e bëra. Propozoi, z.Patriot Rudarin, nga radhët e AAK-së.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votim, fillimisht propozimin që pjesë të grupit punues të jenë nga një anëtarë nga të gjitha subjektet politike përfaqësuese në këtë Kuvend.

Njëzëri mbështetet ngritja e Grupit punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2020, në përbërje, si vijon;

1. z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit
2. znj.Fatlume Jaha, nga radhët e LDK-së
3. z.Fitim Muçolli, nga radhët e LVV-së
4. z.Fatmir Rudari, nga radhët e PDK-së
5. z.Patriot Rudari, nga radhët e AAK-së
6. z.Avni Islami, nga radhët e OBKD-së
7. z.Benjamin Ejupi, nga radhët e PD-së
8. z.Blerim Maqastena, nga radhët e PSD-së

4. Të ndryshme

z.Bajram Ajeti, theksoi, edhe pse në takimet tona si grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së përpiqemi që në këtë pikë të rendit të ditës të shtrojmë shumë çështje sepse vërtetë kemi shumë çështje për të ngritur edhe pse pothuajse asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje, megjithatë unë dola të ngrisë një çështje për të cilën jo zyrtarisht kemi marrë një informatë se Komuna apo një shef i urbanizmit, tek shqiponja e që tash më është një shprehje apo një thirrje gjithë populllore për shqiponjën e cila është ngritur tek Hotel Besiana në rreth rrotullim, që do të vëhet një shtyllë për vendosjen e kamareve të sigurisë, dhe atë mu afër shqiponjës, po e ritheksoj se kemi informata jo zyrtarisht, megjithatë ne dëshirojmë t'ju paralajmërojmë se në rrethin e shqiponjës të mos preket, sepse ne kemi edhe ekspertë të sigurisë këtu që ka vende dhe territor tjetër mjaft të hapur që ka mundësi të vendosen diku tjetër kamerat e sigurisë, por kurrësi tek shqiponja. Ju lutem, ju paralajmërojmë si asamble dhe si Ekzekutiv që një hap i tillë të mos merret, përndryshe do të përballeni edhe me protesta sepse për ne ajo është një ngjarje, është një monument dhe është një diçka që na ushqen shpirtnisht jo vetëm neve por të gjithë qytetarët e Llapit, kështu që mos të merret ndonjë vendim si me inate apo si kundërvënie, por të kihet parasysh që një akt i tillë të mos ndodh që të bëhet, faleminderit për mirëkuptim.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së, dje kemi vizituar objektin e mirëqenies për punës sociale, për tu njoftuar persëafërmi për kushtet që posedon ai institucion. Nuk e di ju Ekzekutiv i nderuar a e dini se në çfarë kushtesh po kryenin punë ata punëtorë. Si është e mundur që vit pas viti t’ju tepron buxhet kurse ai institucion nuk ka veturë për kryerjen e nevojave të tyre, si është e mundur që ai institucion të jetë pa drejtor, po ashtu nuk ka psikolog kur dihet roli i psikologut në rastet e paraqitura në këtë institucion, madje nuk ka as kompjuter funksional, as fotokopje ku për një letër duhet ardhur në qytet për të bërë kopje. Paramendojeni që as zarfe për t’i dërguar lëndët nëpër Gjykata nuk kanë, kurse shërbimet postare janë të detyruar t’i paguajnë vetë stafi, ndërsa në raportet financiare kemi rritje të shpenzimeve postare, a thua pse. Përveç tjerash nuk kanë as sigurim ku shpesh herë thonë se jemi të kanosur edhe me armë zjarri. Pra Ekzekutiv i nderuar, është turp të flasim për diçka që është e kapshme dhe e përballueshme për buxhetin komunal, por si duket nuk jeni të informuar.

Çështje tjetër shqetësuese është mungesa e një autoambulance në ambulanten e fshatit Lluzhan kur dihen nevojat dhe kërkesat për atë lokacion pasi që tani kjo rrugë po quhet edhe si rrugë e vdekjes. **znj. Doruntina Hasani**, theksoi, siç jeni në dijeni edhe ju punimet në rr.”Zahir Pajaziti” janë bërë të mërzitshme dhe po na shpenzohen shumë para pa u bërë punime, qe një vit me trotuare midis rruge e që ju keni thënë se vetëm për shkak të motit dhe do të jetë e përkohshme, por kaluan një vit dhe as edhe një punë nuk është bërë, çka është gjithë kjo vonesë, përse nuk po raporton drejtori për këto vonesa, a ka apliku drejtori për penaltete, pastaj gjendja e trotuareve nga caffè bar Pranvera deri tek shkolla ekonomike me rrugën e re është bërë vetëm 1 metër, e që nuk mund të jetë ashtu kur e dim që është pjesë kryesore e qytetit dhe që shumë qytetarë kalojnë brenda ditës aty por që patjetër qytetarëve do t’iu duhet të dalin në rrugë për të kaluar në atë pjesë. Pastaj niveli i trotuareve është aq i lartë sa që vetëm i keni mundësuar ujit të rrinë mbi të e që vetëm me një reshje të vogël që ndodhi para disa ditëve nuk ke mundur të kalosh andej, çka është ky nivel kaq i dobët u punëve.

Mandej drejtori i vetëquajtur ekspert, vitin e kaluar pjesa më e madhe e tepicës së buxhetit ka qenë e atij drejtori, andaj ai drejtor është në gjendje shumë të keqe dhe duhet të reflektoj e që besoj se duhet të reflektoj edhe shefi i Komunës dhe gjithë ju si asamblist.

Kolegu parafolës z.Bajram Ajeti përmendi edhe kamerat e sigurisë, unë do të doja të dijë përse kamerat e sigurisë po vendosen në shtyllat e vjetra kur jeni në dijeni edhe ju që të njëjtat duhet të zhvendosen në shtylla të reja pas një kohe jo të largët, ç’është kjo, a kemi ne aq buxhet të mjaftueshëm sa të bëjmë kaq shumë ndërrime të tilla.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, sqarim parafolëses, vetëm ia rikujtoj parafolëses se drejtori të cilit ajo iu referua si i ashtuquajtur, ai drejtor është i emëruar në mënyrë të ligjshme dhe me dokument, e nuk është ashtu siç e ceku këshilltarja parafolëse (drejtor i vetëquajtura).

z.Arbër Blaku, theksoi, i nderuar Kryesues një shqetësim që kemi marrë tani e disa muaj prej qytetarëve të Podujevës është çështja rreth emërtimit dhe riemërtimit të rrugëve nëpër zona, fshatra dhe qytet, shqetësim për të cilin ka edhe ankesa të deponuara dhe arhivuar në Komunën e Podujevës por që për të cilat nuk ka përgjigje me një arsytim që nuk ka komision funksional, andaj unë kërkoj prej Drejtorisë kompetentet që të paktën në seancën e radhës mundësisht të jetë edhe pikë e rendit të ditës kjo temë në mënyrë që të jepet një sqarim lidhur me këtë problem. Pra propozoj dhe kërkoj që në seancën e radhës, në fillim të muajit dhjetor, të jetë pikë e veçantë e rendit të ditës, informatë e Drejtorisë kompetente lidhur me çështjen e ankesave të emërtimit të rrugëve.

z.Avni Islami, theksoi, do të doja paksa vëmendja më të larët për arsye se sa herë që dal në këtë foltore përpiqem t’i paraqesë shqetësimet e qytetarëve si dhe shkaqet të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në shoqërinë tonë. Brenda 10 ditëve kemi pasur 3 raste të ndryshme të aksidenteve fatale me të vdekur në komunikacion, pra në rrugën kryesore, por meqë Komuna nuk ka akses që të

marrë vendime në rrugë nacionale, të paktën ka përgjegjësi në rrugë lokale, kemi rastin i cili më ka shqetësuar kur në udhëkryqin (tek Interexi), i cili nuk është proporcional në vija, e që vetëm brenda 10 ditëve kemi më shumë se 5 aksidente në atë pjesë. Zakonisht aty ku nuk përputhen rrugët në vija diagonale duhet të ketë një rreth rrotullim në mënyrë që të mos kemi aksidente, prandaj propozoj që ata që janë përgjegjës për komunikacion, nëpër udhëkryqet, brenda Komunës ta ken parasysh këtë çështje në mënyrë që të zvogëlohet numri i aksidenteve në komunikacion. E them këtë ngase kamë parë disa udhëkryqe që nuk janë në vija diagonale të drejta në vende të ndryshme të perëndimit, por në ato vende gjithnjë ka rreth rrotullime. Pra ky ishte vetëm një propozim për një shqetësim i cili duhet të merret parasysh dhe të përcillet nga këtu.

z.Avni Fetahu, theksoi, unë thjesht desha të them se prezent këtu në sallë kemi vetëm 3 drejtor të Drejtorive, Nënkyetari i Komunës ishte dhe u larguan me disa drejtor, andaj kjo është një mospërfillje e llojit të vet që këto pyetje po parashtrohen kryesisht për Ekzekutiv dhe ata të mos jenë prezent këtu në sallë. Besoj që do të marrin mësim prej kësaj shtate dhe herave tjera do të qëndrojnë këtu për arsye se pyetjet po parashtrohen për ata.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kjo që parafolësi e tha mendoj se është vërejtje me vend ngase drejtorët e Drejtorive është mirë të vijnë dhe të qëndrojnë në sallë deri në përfundim të mbledhjes sepse ka çështje të cilat ngritën dhe për të cilat mund të jepen përgjigje dhe sqarime aty për aty në mënyrë që të mos mbeten vetëm si pyetje apo shqetësime, por të jepen përgjigje.

z.Gëzim Namani, theksoi, edhe pse u përmend Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në fakt është Drejtoria e Administratës e cila ka në projekt kamerat e sigurisë, andaj edhe po mundohem të jap përgjigje rreth asaj që u tha rreth këtij projekti.

Këshilltari z.Florent Hasani ka qenë në zyrë dhe kemi diskutuar çështjen e vendosjes së kamerës tek rreth rrotullimi ku është vendosur shqiponja dhe ashtu siç i kam thënë këshilltarit të cekur po ju them edhe juve tani. Nuk është se Drejtoria ka përcaktuar pikat se ku do të vendosen kamerat e sigurisë, ne kemi qenë vetëm mbështetje teknike me zyrtarë tanë të IT, për Policinë e Kosovës e cila në bazë të nevojave të tyre ka caktuar pikat ku do të vendosen kamerat e sigurisë dhe një ndër pikat e caktuara është edhe pika tek ai rreth rrotullim. Projekti si i tillë ka qenë para se shqiponja të vendoset aty dhe nuk është që ne kemi qenë në dijeni se do të vendoset shqiponja në atë hapësirë, si dhe nuk qëndron ajo kinse ne po bëjmë diçka për inat, përkundrazi lidhur me këtë jemi duke punuar për nevoja të sigurisë së qytetarëve të Komunës së Podujevës, madje që nuk kemi të bëjmë me inate dëshmon fakti edhe tek rre rrotullimi i ashtuquajtur (i Kërpimehut) ku shtylla është mu në rreth për shkak se vendoset kamera rrotulluese. Prandaj i kam thënë edhe këshilltarit të lartcekur se nuk kemi asgjë kundër vendosjes së shqiponjës apo kundër atij monumenti por kemi të bëjmë me pikë të përcaktuar nga Policia, por nëse Policia e konsideron se ajo pikë duhet të hiqet ose fare nuk duhet të mbulohet me kamera një aks i cili është goxha i rëndësishëm për shkak se mbulon vijën për Merdar, atëherë është çështje e thjesht, Komuna mund ta zhvendos tjetër kund sepse janë pika të përcaktuara nga Policia e jo Komuna, kështu që në këtë drejtim nuk kemi çfarë të diskutojmë më tepër.

Konkretisht, ne si Komunë jemi bartës të projektit dhe është investim i Komunës si dhe kemi ofruar mbështetje teknike me zyrtarë tanë të IT-së, kurse pikat janë caktuar nga Policia në bazë të nevojave të tyre ku ata e kanë paraparë të nevojshme për sigurinë e përgjithshme.

Sa i përket çështjes tjetër që u tha se përse po vendosen në shtylla të vjetra kamerat e sigurisë, është e vërtetë ajo dhe është për shkak të punimeve në shesh, por kemi marrëveshje me kompaninë përkatëse dhe është lënë kablo shtesë që në momentin kur vendosen shtyllat e reja, kamerat do të zhvendosen në ato shtylla dhe gjithçka do të jetë në rregull, pa kosto shtesë sepse është menduar me kohë kjo çështje.

z.Bajram Ajeti, theksoi, nuk kemi të bëjmë me çështje të interesit të askujt lidhur me vendin ku është vendosur shqiponja, mirëpo drejtori parafolës z.Gëzim Namani ishte shumë kontradiktor sepse vazhdimisht e thotë se një njëjërën anë ne jemi financues, në anën tjetër e thotë se nuk përcaktojmë vende ne, kështu që përgjigja ishte kontradiktore. Nëse Komuna nuk ka përgjegjësi, ti drejtor duhet të thuash, *drejtohuni Policisë sepse nuk kemi qasje në këtë çështje*, e jo të thoni edhe i financojmë, edhe i vendosim në shtylla të vjetra, edhe kemi lënë kablo shtesë, edhe i rivendosim sërish, kjo do të thotë është diçka që nuk e sqaron mirë problemin. Edhe deklarimi i drejtorit ishte “te rrethi”, dakord është kjo tek rrethi po, ama jo në rreth dhe dallojnë këto. Tek rrethi edhe ne e potencuam që në fillim sepse ka hapësirë të mjaftueshme ku mund të vendoset dhe të kap horizont të njëjtë si të ishte në rreth, por jo në rreth të shqiponjës, gjë për të cilën nëse ka nevojë ne ju drejtohem edhe me shkrim, nëse ka nevojë ne do shkojmë edhe në Polici, ama t’i cenohet bukuria ati rreth rrotullimi me shqiponjë dy krenare, besoj që as ju nuk duhet ta pranoni por as ne nuk do ta pranojmë.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të përfunduar, duke jua rikujtuar dhe duke i ftuar anëtarët e Grupit punues për hartimin e planit të punës ë kuvendit, që nga ora 13:00 do të mbahet takimi i grupit ku edhe do të përcaktohem për pikat që planifikohen për përfshirje në planin e punës për vitin 2020, kjo për arsye se siç e ceku Kryesuesi, shpejt planifikojmë të thërrasim edhe një mbledhje të Kuvendit ku një ndër pikat e Kuvendit duhet të jetë edhe propozim plani i punës së Kuvendit për vitin 2020.

Mbledhja përfundoi në ora 11:25

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0089760/19
Podujevë,
22 nëntor 2019**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi**